



Qendra e Studimeve
Parlamentare

BULETIN

www.ascpdp.org



Ambasada Britanike
Tiranë

Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr.1

prill 2006

RICHARD JONES

Ambasador i Britanisë së Madhe në Shqipëri



Jam shumë i gëzuar për mundësinë për të prezantuar të parin nga seria e buletineve elektronike të përgatitur nga Qendra e Studimeve Parlamentare. Këto janë pjesë e një projekti, të financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë, që synon rritjen e transparencës dhe zgjerimin e njohurive të parlamentarëve dhe të opinionit publik në përgjithësi rreth procesit të integritimit në BE.

BE është tashmë në prag të firmosjes të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, të cilën ne e kemi negociuar me Shqipërinë që nga janari 2003. Besimi ynë në gjendjen e demokracisë shqiptare, dhe në kapacitetet e saj për të ecur përpara dhe për të zbatuar Marrëveshjen në praktikë, është një nga arsyet për ndërmarrjen e këtij hapi tani. Nëpërmjet mbështetjes së projekteve të tilla, ne jemi duke treguar angazhimin tonë konkret për të asistuar publikun shqiptar në shpjegimin e implikimeve reale të Integritimit Europian.

Sumica e gjerë e shoqërisë shqiptare mbështet integritimin e Shqipërisë në BE.

(vijon në faqen 2)

I am delighted to be able to introduce the first in this series of electronic bulletins produced by the Centre for Parliamentary Studies. These form part of a project which the British Embassy in Tirana is funding, to help increase transparency and enhance the knowledge of Parliamentarians and public opinion generally about the process of EU integration. The bulletins will spread awareness of the implications of this process for Albania.

The EU now stands ready to sign the Stabilisation and Association Agreement, which we have been negotiating with Albania since January 2003. Our confidence in the state of Albanian democracy, and its capacity to continue to move forward, and to implement the Agreement in practice, is one of main reasons for taking this step now. Through sponsoring projects like this one, we are demonstrating our concrete commitment to assist in explaining the real implications of European integration to the Albanian public.

The vast majority of Albanian society supports Albania's integration into the EU. A greater sense of responsibility, and awareness of the complexity of the inte-

(see page 2)

Në këtë numër:

1. Richard Jones, Ambasador i Britanisë së Madhe në Shqipëri *faqe 1-2*
2. Hyrje. Objektivat e Programit *faqe 1-2*
3. Strukturat dhe Instrumentat Monitorues në Marrëdhëniet Shqipëri-BE
Ditmir Bushati *faqe 3-4*
4. Roli i Parlamentit Shqiptar në Çështjet e Integritimit Sokol Berberi *faqe 5-6*
5. Projekt rekomandimet e Përbashkëta nga Takimi i 13-të i CTF (shqip/anglisht) *faqe 7-10*
6. Nga Punimet e Kuvendit për muajin prill 2006 *faqe 11-13*
7. Nga Veprimtaria e Komisionit të Integritimit prill 2006 *faqe 14-16*
8. Kalendari 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 22 maj - 12 qershor 2006 *faqe 16-18*

“Rritja e rolit dhe përgjegjshmërisë së Parlamentit Shqiptar në procesin e Integritimit në BE nëpërmjet veprimtarive legjislative me pjesëmarrje të gjerë dhe transparente” “Increased Transparency and Information of Parliamentarians and Interest Groups on European Union Integration Processes”

Projekt i propozuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare dhe i mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë. Projekti shtrihet në periudhën prill 2006-prill 2007.

Qëllimi

Rritja e rolit dhe përgjegjshmërisë së Parlamentit Shqiptar në procesin e Integritimit në BE nëpërmjet aktiviteteve legjislative me pjesëmarrje të gjerë dhe transparente.

Përmbledhje

Parlamenti ka një rol të rëndësishëm në zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociimit dhe në përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis communautaire*. Duke gjykuar nga monitorimi paraprak i aktivitetit të parlamentit nga QSP, pjesa më e madhe e anëtarëve të parlamentit nuk kanë një rol aktiv në hartimin e legjislacion-

(vijon në faqen 2)

This project is proposed by Center for Parliamentary Studies and supported by British Embassy in Tirana for the time period April 2006 – 2007.

Project Purpose

To increase the role and responsibility of the Parliament of Albania in the country's EU integration process through participatory and transparent legislative activities.

Rationale

Parliament has a crucial role in implementing the Stabilisation and Association Agreement and in the approximation of domestic legislation with *acquis communautaire*. Judging from CPS previous monitoring of the Parliament's activity, most MPs do not take an active role in legislation drafting. Also, not many of them seem to

(see page 2)

RICHARD JONES

Ambasador i Britanisë së Madhe në Shqipëri

(vijon nga faqja 1)

Sot, gjithashtu, kërkohet të shfaqet një sens më i madh përgjegjësie dhe ndërgjegjësimi për kompleksitetin e procesit të integrimit. Por, ngelet shumë për të bërë përpara se e gjithë shoqëria shqiptare – politikanët dhe shoqëria civile – të kuptojë se çfarë përfaqëson integrimi në të vërtetë. Megjithatë anëtarësimi nënkupton vërtet heqje të kontrolleve strikte të vizave për udhëtime në pjesën tjetër të Europës dhe akses në programe të konsiderueshme asistence të ofruara nga Komuniteti, ai, gjithashtu nënkupton përfundim të një pjese të madhe të Ligjit komunitar, që vendos përgjegjësi dhe detyrime të reja jo vetëm mbi Qeverinë Shqiptare por, së fundi, edhe te qytetarët shqiptarë. Integrimi është një mal shumë i lartë për t'u ngjitur. Por eksperiencën e zgjerimit të antarësisë që sapo ka ndodhur, tregon se arritja në majë është e mundur, por ju mund të arrini aty vetëm nëse njihni rrugën që duhet të ndiqni dhe nëse keni hartat dhe pajisjet e nevojshme në dispozicionin tuaj. Shpresoj që këto buletine do të ndihmojnë në plotësimin e këtyre nevojave.

gration process, is also now emerging. But there remains much to do before the whole of Albanian society - politicians and civil society alike - understands what integration really means. Although membership will indeed mean the removal of strict visa controls for travel to the rest of Europe, and access to considerable programmes of assistance from the Community, it will also mean adopting a great body of Community law, imposing new responsibilities and obligations on not only the Government of Albania, but also, ultimately, on Albanian citizens.

Integration is a huge mountain to climb. But the experience of previous enlargement shows that reaching the summit is possible, but you can only get there if you know the path you have to take, and have the right maps and equipment at your disposal. I hope that these bulletins will help meet that need.

“Rritja e rolit dhe përgjegjshmërisë së Parlamentit Shqiptar në procesin e Integrimit në BE nëpërmjet veprimtarive legislative me pjesëmarrje të gjerë dhe transparente” “Increased Transparency and Information of Parliamentarians and Interest Groups on European Union Integration Processes”

(vijon nga faqja 1)

it. Gjithashtu, duket që jo shumë prej tyre janë të mirëinformuar se çfarë përfshin procesi i stabilizimit asociativ në BE. Projekti do të asistojë parlamentarët dhe parlamentin në identifikimin e çështjeve të Procesit të Stabilizimit Asociativ të cilat duhet të adresohen në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Aktivitetet e projektit

- Monitorimi i performancës së Komisionit të Çështjeve të Integrimit Europian dhe strukturave të tjera parlamentare ;
- Grupe pune me zyrtarë dhe ekspertë të integrimit për vlerësimin e metodave dhe procesit të përafritimit të legjislacionit dhe hartimit e rekomandimeve për Ministrinë e Integrimit, Komisionin e Integrimit në Parlament dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë proces;

- Angazhimi i një eksperti mbi përafritimin e legjislacionit me BE-në dhe mbi PSA në përgjithësi, mundësisht nga një prej vendeve të reja anëtare në BE; Nëpërmjet takimeve në Ministrinë e Integrimit Europian janë identifikuar disa informacione kontaktesh mbi ekspertë të mundshëm që kanë pasur një eksperiencë të mëparshme në Shqipëri.

- Rritja e ndërgjegjësimit / sesione informuese me komisionet parlamentare dhe grupet e interesit (të rinjtë, unionet tregtare, OJF, gratë, bizneset, etj.) mbi çështjet aktuale të integrimit.

- Tryeza te rrumbullakta me aktorë të ndryshëm të integrimit: ekspertë, zyrtarë, Institucione të BE-së të përfaqësuar në Shqipëri, OJF;

- Shpërndarja e një buletini elektronik informativ;

- Broshura informative mbi çështjet e BE-së;

Impakti / Qëndrueshmëria e përfitimeve (rezultateve):
- Proceste transparente të Integrimit dhe përafritimit të legjislacionit;

- Rritja e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së ekzekutivit ndaj pushtetit legjislativ mbi çështjet e Integrimit europian dhe monitorimi parlamentar;

- Rritja e numrit të anëtarëve të parlamentit, të informuar mbi çështjet e integrimit: dhe vendime më cilësore dhe eficiente legjislativ;

- Rritja e nivelit të ndërgjegjesimit të opinionit publik mbi procesin e integrimit europian, impaktin, përfitimet, si edhe detyrimet që derivojnë nga ky proces.

know about what Albania's SAP (Stabilisation and Association Process) with the EU entails. The project will assist MPs and the Parliament by identifying SAP issues that should be addressed in the short-medium and long-term.

Project Activities

- Monitoring of parliamentary commissions' performance on EU integration matters;

- Working groups with integration experts and officials to review methods and process of approximation of legislation and drawing of recommendations for the Albanian Ministry of Integration, Parliament Integration Committee and other involved institutions;

- Employment of expert on EU approximation legislation and SAP in general, preferably from a new member state;

- Awareness raising /informative sessions with parliamentary committees and interest groups (youth, trade unions, NGOs, women, businesses, etc) on current legislation issues;

- Round tables with various integration actors: experts, officials, EU institutions represented in Albania, NGOs;

- Informative electronic bulletin delivery;

- Informative booklets on EU matters;

Impact /Sustainability of benefits (results):

- Transparent integration and EU legislation approximation processes;

- Increased responsibility and accountability of the executive towards the legislative power on matters of EU integration and parliamentary scrutiny;

- Increased number of MPs informed on matters of EU Integration: more qualitative and efficient legislative decisions;

- Increased level of awareness of public opinion on the process of EU integration, impact, benefits, as well as obligations deriving from this process.

STRUKTURAT DHE INSTRUMENTAT MONITORUES NË MARRËDHËNIET SHQIPËRI-BE

- **Grupi Konsultativ i Përbashkët BE-Shqipëri**, është një ndër strukturat e përbashkëta me BE-në në procesin e integritimit evropian i cili monitoron progresin e Shqipërisë në zbatimin e reformave sektoriale.

Takimet e Grupit Konsultativ BE-Shqipëri pasohen nga **Rekomandimet e Përbashkëta**, të cilat pasqyrojnë diskutimet e bëra gjatë takimeve, çështjet problematike të ngritura në të dhe që duhen zgjidhur, të shoqëruara në pjesën më të madhe me afate kohore të përcaktuara qartë për përbushjen e tyre. Ndjekja dhe zbatimi në kohë i këtyre rekomandimeve është në fokusin kryesor të punës së Ministrisë së Integritimit Evropian si strukturë koordinuese dhe monitoruese e këtij procesi, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet qendrore.

- **Komiteti i Përbashkët Shqipëri-Bashkimi Evropian**, është një strukturë tjetër monitoruese, organ ky i ngritur në kuadër të Marrëveshjes mbi Tregëtinë dhe Bashkëpunimin Ekonomik e vitit 1992.

Komiteti i Përbashkët shqyrton progresin e arritur nga institucionet shqiptare gjatë një viti në fushat e mbuluara nga marrëveshja si tregëtia, ekonomia, infrastruktura dhe përafrimi i legjislativëve me *acquis communautaire*. Objekt i takimeve të Komitetit të Përbashkët janë edhe çështje që kanë të bëjnë me demokracinë dhe shtetin e së drejtës si dhe reformat në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Në kuadër të këtij Komiteti funksionojnë disa **grupe pune** që shqyrtojnë çështje sektoriale lidhur me infrastrukturën, ekonominë dhe financën, tatimet dhe doganat, bujqësinë, reformën dhe përafrimin e legjislativëve. Këto grupe mbledhen në mënyrë periodike, një herë në vit, dhe trajtojnë progresin e bërë që nga takimi i fundit. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme që do t'i paraprijë hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, grupet e punës do të formohen gradualisht në përputhje me fushat kryesore të MSA-së. Ndërkohë, Komiteti i Përbashkët do të mbikqyrë zbatimin e Marrëveshjes së Përkohshme deri në krijimin e Këshillit të Stabilizim Asociimit, i cili do të bëhet operacional me hyrjen në fuqi të MSA-së.

Raporti Vjetor i Komisionit Evropian është një instrument tjetër kontrolli dhe njëkohësisht përmbledhës i ecurisë së reformave të ndërmarra nga Shqipëria. Raporti trajton në mënyrë të hollësishme gjendjen e vendit në të gjitha aspektet politike, institucionale, ligjore dhe ekonomike si dhe sugjeron çështjet në të cilat duhet të përqendrohet vëmendja dhe përmirësimi gjatë 12 muajve të ardhshëm.

Raporti Vjetor është sintezë e procesit të vazhdueshëm të monitorimit që BE i ka bërë progresit të reformave në Shqipëri gjatë 12 muajve. Momenti i rëndësishëm në procesin e monitorimit është vlerësimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në MSA.

Raporti Vjetor paraprihet nga progres-raportet tre-mujore që përgatit Këshilli i Ministrave në bazë të kontributeve të ardhura nga institucionet qendrore dhe ato të linjës për ecurinë e reformave. Progres raportet u paraqiten shërbimeve të Komisionit Evropian dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë (trupit diplomatik, organizatave ndërkombëtare të vendosura në vendin tonë). Progres raportet trajtojnë realizimet/mosrealizimet, dhe shkaqet për mosrealizime si dhe masat e ndërmarra për përbushjen e tyre në vazhdim.

- **Partneriteti Evropian**

Katër vjet para fillimit të Procesit të Stabilizim Asociimit, duke pasur parasysh zhvillimet e vendeve të përfshira në këtë proces si dhe nevojën për të strukturuar më qartë perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Këshilli Evropian, në takimin e tij të 19-20 Qershorit 2003, adoptoi dokumentin "Afhenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: Drejt Integritimit Evropian". Afhenda e Selanikut u adoptua në Samitin e Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive të Shteteve

Anëtare të BE-së, Shteteve Kandidate dhe Shteteve në Procesin e Stabilizim Asociimit (21 Qershor 2003), si një dokument i përbashkët i BE-së dhe vendeve në Procesin e Stabilizim Asociimit.

Procesi i Stabilizim Asociimit u pasurua me element të rinj të procesit të zgjerimit: **Partneritetet Evropiane** të cilat frymëzohen nga **Partneritetet e Anëtarësimit**¹ që ndihmuan në përgatitjen e vendeve të Europës për anëtarësimin e tyre në Bashkimin Evropian. Partneritetet Evropiane bazohen në Raportet Vjetore të vendeve të përfshira në Procesin e Stabilizim Asociimit dhe janë përgatitur në përshtatje me nevojat specifike të secilit prej vendeve, duke përcaktuar prioritetet afatshkurtra (1-2 vjet) dhe ato afatmesme (3-4 vjet).

Mbi këtë bazë, Republikës së Shqipërisë iu propozua Partneriteti Evropian pas miratimit të këtij dokumenti nga Këshilli i BE-së në Qershor 2004 (Vendimi 2004/519/EC). Qeveria e Republikës së Shqipërisë përgatiti Planin e Veprimit për Zbatimin Prioriteteve të Partneritetit Evropian, i cili u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 634, dt. 30.08.2004. Plani ndahet në 3 kapituj kryesorë:

- Gjendja Politike
- Gjendja Ekonomike
- Standartet Evropiane.

Plani i Veprimit trajton 8 fusha prioritare, të ndara në 31 sektorë, të cilët adresojnë rreth 190 objektiva afat-shkurtra (1-2 vjet) dhe afat-mesme (3-4 vjet) në përshtatje me prioritetet e identifikuar në dokumentin e Partneritetit Evropian.

Qëllimi i Planit është të përshkruajë në një kuadër të vetëm: objektivat specifike prioritare për arritjen e standarteve të kërkuara nga procesi i Stabilizim Asociimit në këto sektorë, masat dhe veprimet specifike për arritjen e këtyre objektivave, institucionet përgjegjëse, afatet kohore për realizimin e çdo mase apo veprimi, si dhe mjetet financiare të nevojshme për çdo masë.

Në bazë të Vendimit të Ministrave Nr 634, datë 30.08.2004, "Për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Përpalesive të Partneritetit Evropian" institucionet e linjës dhe ato qendrore raportojnë çdo tre muaj, pranë Ministrisë së Integritimit Evropian, mbi progresin e bërë në zbatimin masave të parashikuara në këtë Plan Veprimi.

Ministria e Integritimit Evropian përgatit raportin përmbledhës i cili i paraqitet shërbimeve të Komisionit Evropian, dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. Këto raporte shërbejnë gjithashtu si dokument analize dhe vlerësimi në mbledhjet e Qeverisë apo të Komitetit Ndërmintor të Integritimit Evropian për punën e bërë dhe problematikat në zbatimin e detyrimeve nga të gjitha institucionet përgjegjëse.

- **Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislativëve Vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga MSA**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 185, datë 17.11.2004 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislativëve vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit", u hartua Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislativëve vendas dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, i cili përbën instrumentin bazë për planifikimin, priorizimin dhe monitorimin e procesit të integritimit Evropian të Shqipërisë. Plani adreson:

- Detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja në përshtatje me kapitujt e *acquis communautaire*;
- Afhendën e Selanikut;
- Prioritetet e Partneritetit Evropian;
- Rekomandimet e takimeve të formateve të ndryshme BE-Shqipëri;
- Raportet vjetore të Komisionit Evropian mbi ecurinë e procesit të stabilizim-asociimit.

(vijon në faqen 4)

STRUKTURAT DHE INSTRUMENTAT MONITORUES NË MARRËDHËNIET SHQIPËRI-BE

(vijon nga faqja 3)

Plani është një burim i vetë-mjaftueshëm informacioni, organizuar në një pjesë përshkruese dhe në tabela monitoruese. Plani ndahet në dy faza: Objektivi kryesor i fazës së parë është kuptimi dhe krahasimi i angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria në procesin e Stabilizim Asociimit parë nga këndvështrimi i përafrimit gradual të legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe ndërtimit të kapaciteteve të nevojshme administrative për zbatimin e tij në praktikë. Objektivi kryesor i fazës së dytë është identifikimi i masave të nevojshme për përmbushjen e objektivave.

Në zbatim të MSA-së, Plani mbulon një periudhë 10 vjeçare, e cila është ndarë në periudha afatshkurtra dhe afatmesme, sipas kriterëve të Partneritetit Europian. Prioritetet klasifikohen në bazë të periudhave tranzitore të MSA, duke e vënë theksin në periudhën e parë të zbatimit të MSA-së të përcaktuar në nenin 70 lexuar në bashkëveprim me nenin 6 të saj. Kuadri kohor është i organizuar në periudhat:

- Afatshkurtër: vitet 2005-2006
- Afatmesëm: vitet 2007-2008
- Afatgjatë: vitet 2009-2014

Struktura e Planit është e njëjtë me atë të raporteve vjetore të Komisionit Europian dhe përfshin brenda saj edhe Planin e Veprimit në zbatim të Përparësive të Partneritetit Europian. Plani është i ndarë në tre kapituj kryesorë: gjendja politike, gjendja ekonomike, standardet Europiane

Gjendja Politike trajton çështje të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, demokratizimin e mëtejshëm të jetës parlamentare, përgatitjet e institucioneve shqiptare për zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare, reformat në administratën publike dhe sistemin gjyqësor, luftën kundër korrupsionit, lirinë e medias, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare, institucionet e vuajtjes së dënimit dhe sistemin e drejtësisë për të miturit si dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në kuadër të angazhimeve të ndërmarra në Samitin e Selanikut të vitit 2003 dhe detyrimeve që rrjedhin nga antarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Gjendja Ekonomike analizon reformat e ekonomisë së tregut të lirë dhe ato strukturore, krijimin e një klime të përshtatshme për zhvillimin e biznesit, zhvillimin e politikave të punësimit dhe forcimit të kohezionit social si dhe menaxhimin e financave publike në përputhje me standardet e BE-së.

Standardet Europiane ose thënë ndryshe aftësia e një vendi aspirant për të patur me Bashkimin Europian një regjim asociimi e më pas antarësimi, përfshijnë detyrimin për të adoptuar në mënyrë graduale – sipas afateve të rëna dakord në MSA – normativën komunitare si dhe ndërtimin e strukturave administrative të afta për zbatimin korrekt të legjislacionit të miratuar.

Plani bën dallim ndërmjet dy kategorive të ndryshme të masave: ligjore dhe jo-ligjore (zbatuese), duke adoptuar korpusin e *acquis communautaire* në sistemin vendas gjatë periudhës së implementimit të MSA-së. Për të bërë të mundur një programim më të mirë të asistencës së huaj e kryesisht asaj komunitare, Plani identifikon projektet dy ose shumë palëshe me një citim të titullit, buxhetit në dispozicion ose një përshkrim i shkurtër i përbërësve, aktiviteteve dhe statusit të implementimit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 317, datë 13.05.2005, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe zbatimit të Angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit" ngarkon Ministrinë e Integritit Europian me ndjekjen e progresit të realizuar nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore në zbatimin e masave të parashikuara në Plan. Mbi këtë bazë, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore në varësi të Këshillit të Ministrave raportojnë në Ministrinë e Integritit Europian, në fillim të çdo tremujori, për realizimin

e detyrave që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Raportimi përfshin si pjesë integrale të tij edhe progresin e realizuar në kuadër të zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 634, dt. 30.08.2004 "Për Miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Partneritetit Europian".

Sipas po të njëjtit Vendim të Këshillit të Ministrave ministritë dhe institucionet e tjera qendrore brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e Vendimit për miratimin e Planit, janë të detyruara të paraqesin në Këshillin e Ministrave planet e tyre të punës në lidhje me:

- nevojat për personel dhe trainime për funksionet e reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese me qëllim zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.
- nevojat financiare për zbatimin e masave afatshkurtra të parashikuara në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-se dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit; Duke qenë se Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-se dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit integron në një dokument të vetëm MSA-në, prioritetet e Axfordës së Selanikut dhe prioritetet e Partneritetit Europian – që përbëjnë kuadrin detyrues dhe monitorues të procesit të integritit europian të Shqipërisë – si dhe duke njohur faktin që Plani ruan të njëjtën strukturë me Raportin Vjetor të Komisionit Europian, ai (Plani) përbën instrumentin e vetëm monitorues të procesit të integritit Europian.

Përditësimi

Këshilli i BE-së nëpërmjet vendimit të datës 30 janar 2006, (2006/54/EC) miratoi një Partneritet të ri Europian me Shqipërinë duke shfuqizuar në të njëjtën kohë vendimin e Qershorit të vitit 2004. Partneriteti i ri i përmbahet të njëjtës filozofi me atë të vitit 2004 duke përcaktuar disa prioritetet e reja për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme të cilat duhen adresuar nga Shqipëria. Një pjesë e këtyre prioritetëve natyrisht që nuk gjejnë pasqyrim në Planin ekzistues. Për pasojë lind nevoja e përditësimit të tij me këto prioritetet.

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr. 32 datë 22.2.2006 "Për krijimin e Grupit Ndërmënor të punës për përditësimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit dhe zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit", plani i përditësuar me prioritetet e reja të Partneritetit Europian, programin e qeverisë së re dhe programin buxhetor afatmesëm do të miratohet në Këshillin e Ministrave brenda muajit Qershor të vitit 2006. Rëndësia e këtij dokumenti është esenciale po të mbahet në vëmendje fakti që Shqipëria është në prag të nënshkrimit të MSA-së dhe Marrëveshja e Përkohshme pritet të hyjë në fuqi brenda verës së këtij viti. Në këtë kontekst, plani do të shërbejë si instrumenti vlerësues i aftësisë së Shqipërisë për t'iu përgjigjur prioritetëve të Partneritetit Europian dhe detyrimeve të MSA-së.

Shënime

¹ Sipas "Glossary" të Bashkimit Europian: "*Partneritetet për Aderim përmblodhin në një dokument të vetëm ndihmën që Komuniteti Europian i ofron secilit vend aplikant dhe përcaktojnë përparësitë për secilin sektor në adoptimin e acquis communautaire. Pas Partneritetit për Aderim, secili vend harton një program të detajuar për miratimin e acquis për të organizuar zbatimin e këtyre prioritetëve, duke ju përmbajtur një afati kohor dhe duke treguar burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare. Programet dhe Partneritetet për Aderim herë pas here pësojnë ndryshime nga Komisioni Europian dhe nga shteti i interesuar*".

Ditmir Bushati

ROLI I PARLAMENTIT SHQIPTAR NË ÇËSHTJET E INTEGRIMIT

Parlamenti shqiptar ka një rol qendror dhe thelbësor në procesin e integrimit europian. Kuvendi, nëpërmjet karakterit përfaqësues të tij i jep legjitimitetin e nevojshëm këtij procesi. Angazhimi dhe veprimtaria parlamentare në çështjet europiane ka evidentuar nevojën për një rregullim më të plotë dhe të qartë të kuadrit ligjor dhe institucional që rregullon funksionet dhe raportet e aktorëve kryesorë në këtë proces.

Ligji Nr.9252, datë 8.7.2004 "Për punën e Kuvendit në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian", ose i njohur ndryshe Ligji "Zela", ka vendosur rregulla të veçanta për rolin që duhet të luajë dhe punën që duhet të kryejë Kuvendi, si organi më i lartë ligjvënës në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit. Ky rol, sipas ligjit, lidhet me hartimin e një kuadri të plotë ligjor, mbështetjen dhe mbikqyrjen e procesit të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian.¹

Kuvendi, përsa i përket funksionit legjislativ, ngarkohet nga ligji Zela për krijimin e një kuadri rregullator të marrëdhënieve politike, institucionale, ekonomike, tregtare dhe ligjore ndërmjet Shqipërisë nga njëra anë, dhe Komunitetit Europian e shteteve anëtare të Bashkimit Europian, nga ana tjetër; si dhe për trajtimin me përparësi për përaftrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian.

Në aspektin politik, ligji ngarkon Kuvendin për ndërtimin e kuadrit të përshtatshëm për dialogun politik ndërmjet palëve si dhe nëpërmjet angazhimit më të drejtpërdrejtë për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe më gjerë.²

Ligji përcakton detyrime për Këshillin e Ministrave përsa i përket informacionit që duhet t'i dërgojë Kuvendit si dhe konsultimit që duhet të bëjë me këtë të fundit respektivisht për punën e bërë pranë institucioneve të ndryshme të Bashkimit Europian dhe qëndrimet që do të mbajë qeveria në këto institucione.

Kuvendi merr angazhim, sipas ligjit, për ngritjen dhe fuqizimin e sektorëve specifikë kërkimorë që mund të merren vetëm me problemet e integrimit.

Rregullorja e re e Kuvendit³ ka përcaktuar në mënyrë eksplicite detyrimin që, relacioni që shoqëron projektligjet të përmbajë, ndër të tjera, edhe harmonizimin e ligjit të propozuar me legjislacionin e bashkimit Europian.⁴ Kryetari i Kuvendit, sipas Rregullores, në mënyrë të arsyetuar, mund t'ja kthejë nismëtarit projektligjin e depozituar, në rast se propozimi i ligjit nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë Rregullore, ku përfshihet dhe ajo e përmendur më sipër.⁵ Një kërkesë e tillë parashikohet edhe në Rregulloren e Këshillit të Ministrave të vitit 2003.⁶ Relacioni shpjegues që shoqëron projektaktet normative që i paraqiten Këshillit të Ministrave, sipas kësaj Rregulloreje, ndër të tjera, duhet të përmbajë: "Vlerësimin eventuale të shkallës së përaftrimit të përmbajtjes së tyre me legjislacionin komunitar (acquis communautaire)."⁷

Veprimtaria Parlamentare legjislative mbi çështjet e integrimit Europian

Çdonjëri nga 8 komisionet e përhershme parlamentare mbulon një fushë të caktuar. Në veprimtarinë e tyre legjislative dhe kontrolluese, çdo komision ndjek edhe çështjet që lidhen me përaftrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian dhe zbatimin e masave institucionale në sektorin përkatës.

Në bazë të rregullores së re të Kuvendit, puna përgatitore për shqyrtimin e një projektligji i besohet një komisioni të vetëm dhe sipas rastit, caktohen një ose disa komisione të tjera që japin mendimin e tyre. Përcaktimi i komisionit përgjegjës dhe komisioneve që duhet të japin mendim bëhet në programin e punës dhe në kalendarin e punimeve nga kryetari i Kuvendit sipas sugjerimeve paraprake të shërbimeve juridike.

Sipas rregullores, komisioni përgjegjës bën shqyrtimin bazë të projektligjit duke paraqitur një raport tërësor të përgatitur nga relatori, kurse komisionet ndihmëse bëjnë vlerësime për nene të veçanta ose japin mendime për çështje të caktuara. Vlerësimet e komisioneve ndihmëse i paraqiten komisionit përgjegjës dhe shënohen në rendin e ditës së seancës plenare.

Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve

Në procesin e zbatimit të MSA-së, mbështetur në eksperiencën e vendeve të tjera që kanë kaluar në këtë proces, parashikohet një veprimtari legjislative me një volum shumë të madh për transpozimin e legjislacionit të BE-së.⁸ Në këtë kuadër vende tashmë anëtare të BE-se si dhe vende kandidatë kanë vlerësuar procedurat e tyre legjislative për t'ju përgjigjur detyrimeve që lidhen me integrimin por, në të njëjtën kohë për të ruajtur legjitimitetin që kërkon ky proces. Këto vlerësime nuk kanë 'kursyer' edhe kuadrin kushtetues të këtyre vendeve. Procedura e përshpejtuar në shqyrtimin e projektligjeve është një nga instrumentet që është përdorur në këtë drejtim.

\Kushtetuta parashikon se "Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë dhe të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit".⁹ Procedura e përshpejtuar nuk mund të zbatohet për projektligjet që rregullojnë: organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta; shtetësinë; zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore; referendumet; kodet; statusin e funksionarëve publikë; amnistinë; ndarjen administrative të Republikës.¹⁰

Kuvendi ka rregulluar në mënyrë më të detajuar procedurën e përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjeve. Kërkesa për procedurë të përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjit duhet të votohet në Kuvend me njoftimin që i bën Kryetari i Kuvendit. Afati brenda të cilit duhet të shqyrtohet projektligji në komision dhe në seancë plenare, sipas Rregullores, nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare. Gjatë programit 12-javor të punës së Kuvendit, mund të shqyrtohen deri në tre projektligje me procedurë të përshpejtuar dhe për programin 3-javor mund të shqyrtohet një projektligj me këtë procedurë.¹¹

Veprimtaria legjislative e Komisionit të Integrimit

Një nga çështjet kryesore që shqyrton ky komision është përputhshmëria e projektligjeve me acquis communautaire dhe përgatitja e raporteve shoqëruese duke përfshirë direktivat e Bashkimit Europian që duhet

(vijon në faqen 6)

ROLI I PARLAMENTIT SHQIPTAR NË ÇËSHTJET E INTEGRIMIT

(vijon nga faqja 5)

të mbahen parasysh. Raportet e përgatitura dhe të miratuara nga anëtarët e komisionit i dërgohen komisioneve të tjera parlamentare dhe rekomandimet e përfshira mbahen në konsideratë gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjeve.

Derisa politikat e integritimit kanë si karakteristika trajtimin e tyre si politika të brendshme, komisionet parlamentare sektoriale, - siç rezulton nga eksperiencia e vendeve anëtare të BE-së-, në dallim nga Komitetet e Çështjeve Europiane duhet të përfshihen më shumë në diskutimet e BE-së dhe jo t'iu shmangen këtyre debateve duke ia kaluar përgjegjësinë Komiteteteve të Çështjeve Europiane (në ato vende ku ekzistojnë).

Veprimtaria kontrolluese parlamentare për çështjet e integritimit Europian

Kuvendi dhe komisionet parlamentare në ushtrimin e funksionit kontrollues përdorin instrumentat e pyetjeve, interpelancave dhe mocioneve. Rregullorja e Kuvendit përcakton procedurat përkatëse për përdorimin e këtyre mjeteve të kontrollit parlamentar.¹² Këto instrumenta mund të përdoren në mënyrë efektive nga Kuvendi në ushtrimin e rolit mbikëqyrës për procesin e integritimit europian.

Ligji Zela parashikon disa mjete specifike për kontrollin parlamentar që lidhet me procesin e integritimit. Kështu, sipas këtij ligji, Këshilli i Ministrave, gjatë dymujorit të parë të çdo viti, duhet të paraqesë një raport mbi ecurinë e marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Europian gjatë vitit paraardhës. Në këtë raport duhen analizuar në mënyrë të veçantë vendimet e marra nga institucionet europiane, veprimtaria e të cilave sjell efekte në bashkëpunimin Shqipëri - Bashkimi Europian, analizohen masat që ka marrë Qeveria si rezultat i këtyre vendimeve, si dhe politikat e ndjekura për të përshtatur politikat sektoriale dhe legjislativin, që përgatit anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ky raport diskutohet në komisionet përkatëse (integritim, politika e jashtme, ekonomia etj) dhe më pas Kuvendi mban pozicionin e tij duke konkretizuar qëndrimin e tij lidhur me ecurinë e procesit të integritimit.¹³ Rast konkret ka qenë përgatitja e rezolutave dhe deklaratave zyrtare, apo organizimi i seanceve plenare me ministrin e integritimit për prezantimin e këtij raporti në Kuvend.¹⁴ Sipas Ligjit Zela, Këshilli i Ministrave i dërgon rregullisht Kuvendit informacione mbi punën e bërë pranë institucioneve të ndryshme të Bashkimit Europian dhe vlerësimet e bëra veçanërisht për:

a) projekt marrëveshjet dhe konventat që duhen lidhur me Bashkimin Europian në kuadër të procesit të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian;

b) projektaktet që kanë të bëjnë me angazhimet në traktatet e Bashkimit Europian, me përjashtim të akteve administrative;

c) projektaktet e së drejtës komunitare, sidomos lidhur me vendimet e përfaqësuesve të qeverive dhe shteteve anëtare të Bashkimit Europian;

ç) projektaktet e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dhe që janë të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë.

Në përmbushje të përgjegjësisë ligjore, Këshilli i Ministrave duhet të konsultohet paraprakisht me Kuvendin lidhur me qëndrimet që do të mbajë në

institucionet e ndryshme të Bashkimit Europian. Ky konsultim është i detyrueshëm kur qëndrimet e Këshillit të Ministrave sjellin përfshirjen e Kuvendit dhe kompetencave të tij.

Në bazë të nenit 5 të ligjit Zela, "për punën e kuvendit në procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian", Komisioni i Integritimit është i detyruar të japë mendimin e tij në rast konsultimesh kur qëndrimet e Këshillit të Ministrave sjellin përfshirjen e Kuvendit dhe kompetencave të tij.

Komisionet e tjera sektoriale duhet të konsultohen paraprakisht për qëndrimet që mbahen dhe negociatat që kryhen, sipas fushës së veprimtarisë së tyre. Kuvendi, në ushtrim të kompetencave të tij, duhet të prononcohet kur e sheh të arsyeshme me një nismë të veten, lidhur me projektet e legjislativin dhe të politikës komunitare. Komisioni Parlamentar i Integritimit, sipas ligjit Zela, duhet të hartojë çdo vit raporte, që shërbejnë si bazë për shqyrtimet që do të bëhen në të gjitha komisionet e Kuvendit, sipas fushave të veprimtarisë së tyre. Kuvendi bën çdo vit një vlerësim gjithëpërfshirës të ecurisë së përafritimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian, duke zhvilluar edhe një seancë plenare me debat.

Shënime

¹ Ligji nr.9252, datë 8.7.2004 "Për punën e Kuvendit në procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian", neni 1.

² Po aty, neni 4.

³ Rregullorja e re e Kuvendit u miratua me Vendimi nr. 166, 2005

⁴ Po aty, neni 68, paragrafi 2.

⁵ Po aty, neni 68, paragrafi 4.

⁶ Kjo Rregullore është miratuar me vendimin nr.584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave.

⁷ Po aty, pika 19, shkronja "d".

⁸ Acquis Communautaire përbën rreth 80 000 faqe tekst. Ndërkohë që ligji komunitar është dinamik dhe në ndryshim të vazhdueshëm.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 83.

¹⁰ Po aty, neni 81.

¹¹ Rregullorja e Kuvendit, neni 28.

¹² Po aty, nenet 89-99.

¹³ Raporti i vitit 2005, u paraqit pranë Kuvendit të Shqipërisë në kohën kur komisionet parlamentare e kishin ndërprerë punën e tyre. Komisioni i Integritimit nuk arriti ta diskutojë dhe të vazhdojë me rekomandimet e tij.

Një kopje e këtij dokumenti ndodhet pranë komisionit të integritimit.

¹⁴ Ligji nr.9252, datë 8.7.2004 "Për punën e Kuvendit në procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian", neni 5.

Sokol Berberi

TAKIMI I 13-të I GRUPIT KONSULTATIV TË PËRBASHKËT BE-SHQIPËRI

13th MEETING OF THE EU/ALBANIA CONSULTATIVE TASK FORCE

Tirana, 8-9 February 2006

PROJEKT REKOMANDIMET E PËRBASHKËTA

Takimi i 13-të i Grupit Konsultativ të Përbashkët BE – Shqipëri (CTF) u zhvillua në Tiranë më 8 Shkurt 2006. Delegacioni i Shqipërisë u drejtua nga Ministri i Integrimit Europian, znj. Arenca Trashani. Delegacioni i BE-së u drejtua nga Ambasadori Klaus Derkoëitsch (Presidenca e BE-së) dhe z. Reinhard Priebe (Komisioni Europian). Qëllimi i mbledhjes së 13-të të CTF-së ishte të vlerësohej progresi i bërë nga Shqipëria në lidhje me:

1. Luftën kundër korrupsionit
2. Luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit
3. Policinë
4. Pastrimin e parave
5. Luftën kundër drogës
6. Gjyqësorin
7. Vizat, kontrollin e kufirit, azilin dhe migrimin

Për rekomandimet e mëposhtëme u ra dakort nga palët:

1. Politika Antikorrupsion

- Shqipëria duhet të vazhdojë të godasë korrupsionin me vendosmëri, duke garantuar që masat e përdorura të harmonizojnë efektivitetin me respektin e lirive individuale, në përputhje me Kushtetutën Shqiptare.

- Shqipëria duhet të përditësojë plan veprimin antikorrupsion të vitit 2004-2005 dhe ta zbatojë atë dhe rekomandimet e Raporteve të Vlerësimit të Grupit të Shteteve të Këshillit të Europës Kundër Korrupsionit (GRECO).

- Shqipëria duhet të sigurojë adoptimin dhe zbatimin në kohë të legjislacionit për të harmonizuar bazën ligjore Shqiptare me Konventat Europiane dhe ato të OKB-së mbi Korrupsionin, që ajo ka ratifikuar.

- Shqipëria duhet të përfshijë anëtarët e gjyqësorit, zyrën e prokurorit dhe shërbimet e zbatimit të ligjit, në diskutimet e Task Forcës për Antikorrupsionin.

- Shqipëria duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Brendëshme dhe të Drejtësisë.

- Shqipëria duhet të forcojë burimet logjistike, njerëzore dhe teknike të Njësisë së Krimit Ekonomik në Policinë e Shtetit dhe të sigurojë trainimet e duhura për oficerët e saj.

- Shqipëria duhet të forcojë lidhjet ndërmjet, policisë, prokurorisë dhe të tjera përkatëse (duke përfshirë këtu Kontrollin e Lartë të Shtetit, Autoritetin e Deklarimit të Pasurive, administratat e taksave dhe doganave) për investigimin dhe procedimin e korrupsionit.

- Shqipëria duhet të sigurojë procedura të përshtatshme gjyqësore për të ndjekur ato raste ku pretendimet për korrupsion kanë çuar në humbjen e postit zyrtar ose në marjen e masave disiplinore.

- Shqipëria duhet të minimizojë humjen e kapaciteteve administrative në departamentet e administratës publike të cilët pësojnë ndryshime të konsiderueshme të stafit si rezultat i masave antikorrupsion.

2. Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

- Shqipëria duhet të vazhdojë të përmirësojë rezultatet e saj konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe, në terma përqindjeje, numrin dhe cilësinë e procedimeve për krimet në këtë fushë dhe të sekuestrimeve dhe konfiskimeve të ardhura nga krimi.

- Në kontekstin e *Action-oriented Measures Against Organised Crime* në të cilin Shqipëria është angazhuar në

(vijon në faqen 8)

DRAFT JOINT RECOMMENDATIONS

The 13th EU/Albania Consultative Task Force (CTF) meeting took place in Tirana on 8 February 2006. The Albanian delegation was led by the Minister for European Integration, Ms. Arenca Trashani. The EU delegation was led by Ambassador Klaus Derkowitsch (EU Presidency) and Mr. Reinhard Priebe (European Commission). The purpose of the 13th CTF meeting was to assess progress made by Albania with regard to:

1. The fight against corruption
2. The fight against organised crime and terrorism
3. Police
4. Money laundering
5. The fight against drugs
6. The judiciary
7. Visa, border control, asylum and migration

The following recommendations were agreed by the parties:

1. Anti corruption policy

- Albania should continue to attack corruption with determination, while ensuring that the measures used combine effectiveness with respect for individual freedoms, in line with the Albanian constitution.

- Albania should update the 2004-2005 anti-corruption action plan and implement both it and the recommendations of the Council of Europe's Group of States Against Corruption (GRECO) Evaluation Reports.

- Albania should ensure the timely adoption and implementation of legislation to harmonise the Albanian legal framework with European and UN Conventions on Corruption which it has ratified.

- Albania should include members of the judiciary, the office of the prosecutor and law enforcement services in the discussions of the Anti-Corruption Task Force.

- Albania should strengthen internal control mechanisms in the Ministries of Interior and Justice.

- Albania should strengthen the logistical, human and technical resources of the Economic Crimes Unit in the Albanian State Police and provide appropriate training to its officers.

- Albania should strengthen the links between the police, the prosecution service and other relevant institutions (including the Supreme Audit Institution, the Declaration of Assets Authority, the customs and tax administrations) for the investigation and prosecution of corruption.

- Albania should give appropriate judicial follow-up to those cases where allegations of corruption have led to loss of office or disciplinary measures.

- Albania should minimise disruption of administrative capacity in public administration departments which undergo significant staff changes as a result of anti-corruption measures.

2. Fighting organised crime and terrorism

- Albania should continue to improve its concrete results in the fight against organised crime, in terms of the rate, number and quality of prosecutions for related offences and the seizure and confiscation of the proceeds of crime.

- In the context of the Action-oriented Measures Against Organised Crime to which Albania has committed in the framework of JHA ministerial meetings, Albania should further enhance co-operation between the various state

(see page 8)

TAKIMI I 13-të I GRUPIT KONSULTATIV TË PËRBASHKËT BE-SHQIPËRI

13th MEETING OF THE EU/ALBANIA CONSULTATIVE TASK FORCE

(vijon nga faqja 7)

Tirana, 8-9 February 2006

PROJEKT REKOMANDIMET E PËRBASHKËTA

DRAFT JOINT RECOMMENDATIONS

kuadër të takimeve ministrore të JHA-së, ajo duhet të rrisë më tej bashkëpunimin ndërmjet organizmave të ndryshme shtetërore në luftën kundër krimit të organizuar, në veçanti ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe policisë.

- Shqipëria duhet të sigurojë që te ketë planifikime për financimin e duhur të Seksionit të Mbrojtjes së Dëshmitarit të Drejtorisë së Krimit të Organizuar në Policinë e Shtetit.

- Shqipëria duhet t'i ofrojë analistëve dhe investigatorëve kundër terroristëve pajisje dhe trainime më të mira.

- Shqipëria duhet të vazhdojë të zgjerojë rrjetin marrëveshjeve bashkëpunuese me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për bashkëpunim operacional në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

- Shqipëria duhet të sigurojë adoptimin në kohë të amendamenteve legjislativë për t'i bërë konventat dhe protokollet ndërkombëtare mbi parandalimin e terrorizmit në të cilat Shqipëria është palë, pjesë të legjislacionit vendas dhe të zbatueshme.

3. Policia

- Shqipëria duhet të marrë në konsideratë nevojën për të forcuar manaxhimin dhe në veçanti strukturat e kontrollit të brendshëm gjatë planifikimit të ndryshimeve të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e policisë së shtetit, duke përfshirë ligjin gradat.

- Shqipëria duhet të sigurojë kalimin nga Ministria e Brendshme në Policinë e Shtetit të përgjegjësisë për manaxhimin e burimeve të saj njerëzore, financiare dhe materiale në mënyrë që të rrisë autonominë e saj profesionale dhe të jetë në linjë me praktikën e përbashkëta të BE-së.

- Shqipëria duhet të përfundojë një marrëveshje strategjike me Europol-in sa më shpejtë të jetë e mundur.

- Shqipëria duhet të finalizojë dhe të verë në funksionim një manual të konsoliduar të procedurave për të gjithë oficerët e policisë sa më shpejtë të jetë e mundur.

- Shqipëria duhet të sigurojë adoptimin dhe zbatimin në kohë të Strategjisë Kombëtare dhe Plan veprimit për Policimin në Komunitet.

- Shqipëria duhet të përmirësojë sistemin e menaxhimit të çështjeve, dhe në këtë kuadër duhet të marrë masa për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet Zyrës së Prokurorisë dhe policisë gjyqësore.

- Shqipëria duhet të adoptojë dhe zbatojë strategjinë e re që kishte zhvilluar për kontrollin e armëve të lehta.

4. Pastrimi i parave

- Shqipëria duhet të sigurojë rezultate konkrete të përmirësuar në një masë të konsiderueshme në zbatimin e legjislacionit për pastrimin e parave, në bazë të procedimeve dhe gjykimeve, dhe zbatimin në mënyrë të plotë të instrumentave të parashikuara nga ligji lidhur me bllokimin e aseteve të lidhura me krimin dhe konfiskimin.

- Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin në mënyrë efektive të Memorandumi të ri të planifikuar të Mirëkuptimit mbi nivelin e bashkëpunimit ndërmjet FIU-së (*Financial Intelligence Unit*), zyrës së prokurorisë dhe Njësisë së Krimit Ekonomik.

- Shqipëria duhet të sigurojë që burimet njerëzore, teknike dhe financiare të FIU-së i përgjigjen detyrave të saj,

(vijon në faqen 9)

bodies involved in the fight against organised crime, in particular between the judicial authorities and the police.

- Albania should ensure that plans are made for adequate funding in the medium term of the Witness Protection Section of the Organized Crime Directorate in the Albanian State Police.

- Albania should provide counter-terrorist analysts and investigators with better equipment and training.

- Albania should continue to extend its network of co-operation agreements with regional and international partners for operational co-operation in the fight against organised crime and terrorism.

- Albania should ensure the timely adoption of legislative amendments to incorporate international conventions and protocols on the prevention of terrorism to which Albania is party into domestic legislation.

3. Police

- Albania should take into account the need to strengthen management and in particular internal control structures when planning amendments to the laws governing the operation of the state police, including the law on ranks.

- Albania should ensure the devolvement from the Ministry of Interior to the Albanian State Police of the responsibility for managing its human, financial and material resources in order to increase its professional autonomy and in line with EU common practice.

- Albania should conclude a strategic agreement with Europol as soon as possible.

- Albania should finalise and put into operation a consolidated manual of procedures for all police officers as soon as possible.

- Albania should ensure the timely adoption and implementation of the National Strategy and Action plan for Policing in the Community.

- Albania should improve the case management system, as part of which it should take concrete steps to improve co-ordination with the Prosecutor's Office and the judicial police.

- Albania should adopt and implement the new strategy which it had developed for small arms and light weapons control

4. Money laundering

- Albania should ensure significantly improved concrete results in the enforcement of anti-money laundering legislation, in terms of prosecutions and trials, and make full use of criminal asset freezing and confiscation tools provided by law.

- Albania should ensure that the planned new Memorandum of Understanding on working-level co-operation between the FIU, the prosecutor's offices and the police Economic Crimes Unit is effectively implemented.

- Albania should ensure that the financial, technical and human resources of the Financial Intelligence Unit (FIU) are commensurate with its tasks, especially the enforcement of transaction reporting obligations.

- Albania should ensure that timely and effective implementation of the planned electronic system for the enforcement of transaction reporting obligations and the

(see page 9)

TAKIMI I 13-të I GRUPIT KONSULTATIV TË PËRBASHKËT BE-SHQIPËRI

13th MEETING OF THE EU/ALBANIA CONSULTATIVE TASK FORCE

(vijon nga faqja 8)

Tirana, 8-9 February 2006

PROJEKT REKOMANDIMET E PËRBASHKËTA

DRAFT JOINT RECOMMENDATIONS

veçanërisht zbatimin e detyrimeve raportuese të transaksioneve.

- Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin efektiv dhe në kohë të sistemit elektronik të planifikuar për zbatimin e detyrimeve raportuese të transaksioneve dhe për të ulur kufirin e raportimit të cilin ky do ta bëjë të mundur.

- Shqipëria duhet të amendojë Kodin Penal për të qartësuar dispozitat penalizuese lidhur me qarkullimin e të mirave materiale të vjedhura, dhe të sigurojë trainime për policinë dhe gjyqësorin në aplikimin e tyre, veçanërisht në fushën e vjedhjes së automjeteve.

- Shqipëria duhet të përmirësojë legjislacionin zbatues mbi menaxhimin e asetëve të sekuestruara dhe të forcojë kapacitetin administrative të agjensisë të ngarkuar për këtë detyrë.

5. Droga

- Shqipëria duhet të arrijë përmirësim të vazhdueshëm në rezultatet konkrete në luftën kundër trafikut të drogës, veçanërisht atë të drogave sintetike, heroinës dhe kokainës.

- Shqipëria duhet të zbatojë plan veprimin në lidhje me Strategjinë Kombëtare Kundër Drogës dhe rekomandimet e *Mini Dublin Group*.

- Shqipëria duhet të sigurojë që masat për identifikimin dhe procedimin e personave përgjegjës në administratën publike për korrupsionin në lidhje me tregtimin e drogës, janë efektive, për shembull duke siguruar që strukturat administrative që lidhin departamentin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Brendëshme, policinë dhe zyren e prokurorisë, funksionojnë mirë.

- Shqipëria duhet të sigurojë shkëmbim më të shpejtë dhe më efektiv të informacionit me partnerët në vendet e tjera në luftën kundër drogës.

- Shqipëria duhet të përmirësojë procedurat për dorëzimin e substancave narkotike të sekuestruara, nga konfiskimi në shkatërrim.

- Shqipëria duhet të përmirësojë udhëzimet për prokurorët në përcaktimin e detyrave specifike për rastet e drogës në varësi të sasive dhe rrethanave të konfiskimit të drogës.

6. Sistemi gjyqësor

- Shqipëria duhet të përdorin plotësisht ekspertizën e ofruar nëpërmjet EURALIUS në hartimin e legjislacionit për reformat, veçanërisht aty ku reformat prekin strukturën e Ministrisë së Drejtësisë ose pjesë thelbësore të sistemit të drejtësisë siç është Këshilli i Lartë i drejtësisë.

- Shqipëria duhet të sigurojë ndjekjen në kohë të studimit të Komisionit të Reformës Ligjore për riorganizimin e Gjykatave të shkallës së parë që synon përmirësimin e efikasitetit të sistemit gjyqësor.

- Shqipëria duhet të rrisë transparencën e procesit të drejtësisë penale dhe civile, duke përfshirë, kështu, zhvillimin e sistemeve elektronike për të lejuar akses në të dhënat rreth statusit të [është]jeve, për zyrtarët në gjyqësor dhe për publikun.

- Masa konkrete, duke përfshirë dhe në terma të procedurës penale, duhet të bide dakord dhe të zbatohet ndërmjet Ministrisë së Brendëshme dhe asaj të drejtësisë për përmirësimin e koordinimit ndërmjet prokurorëve dhe policisë.

lowering of reporting thresholds which this will make possible.

- Albania should amend the Criminal Code to clarify the provisions criminalising the handling of stolen goods, and provide training to the police and the judiciary in applying them, especially in the field of stolen vehicles.

- Albania should improve implementing legislation on the management of sequestered assets and strengthen the administrative capacity of the agency charged with doing so.

5. Drugs

- Albania should achieve sustained improvement in concrete results in the fight against drug trafficking, especially as regards synthetic drugs, heroin and cocaine.

- Albania should implement the action plan related to the National Anti-Drug Strategy and the recommendations of the Mini Dublin Group.

- Albania should ensure that measures to identify and prosecute those responsible for corruption related to the drugs trade in the public administration are effective, for example by ensuring that administrative structures linking the Ministry of Interior's internal control department, the police and the prosecutor's office function well.

- Albania should ensure faster and more effective exchange of information with partners in other countries in the fight against drugs.

- Albania should improve procedures for the handling of sequestered narcotic substances, from seizure to destruction.

- Albania should improve guidance for prosecutors in defining specific charges for drugs cases dependent on quantities and circumstances of drugs seizure.

6. Judicial system

- Albania should make full use of the expertise provided through EURALIUS in drafting reform legislation, particularly where reforms affect the structure of the Ministry of Justice or core parts of the justice system such as the High Council of Justice.

- Albania should ensure timely follow-up of the Legal Reform Commission's study on the reorganisation of Courts of First Instance to improve the efficiency of the judicial system.

- Albania should increase the transparency of the criminal and civil justice process, including through the development of electronic systems to allow access to case status data for judicial officials and the public.

- Concrete measures, including in terms of criminal procedure, should be agreed and implemented between the Ministries of Interior and Justice to improve co-ordination between prosecutors and police.

- Albania should take measures to ensure a better match between the prison population and the infrastructure available to accommodate it.

- Albania should take measures to improve the employment conditions of judicial administrators, including incorporating them into the civil service.

- In consultation with EURALIUS, Albania should take further measures to increase the rate of execution of court rulings.

(vijon në faqen 10)

(see page 10)

TAKIMI I 13-të I GRUPIT KONSULTATIV TË PËRBASHKËT BE-SHQIPËRI

13th MEETING OF THE EU/ALBANIA CONSULTATIVE TASK FORCE

(vijon nga faqja 9)

Tirana, 8-9 February 2006

PROJEKT REKOMANDIMET E PËRBASHKËTA

DRAFT JOINT RECOMMENDATIONS

- Shqipëria duhet të marrë masa për të siguruar një harmonizim më të mirë ndërmjet të dënuarëve në burgje dhe infrastrukturës së disponueshme për t'i akomoduar.

- Shqipëria duhet të marrë masa për të përmirësuar kushtet e punësimit të administratës gjyqësore, duke futur përfshirjen e tyre në shërbimin civil.

- Në konsultim me EURALIUS, Shqipëria duhet të marrë masa të mëtejshme për të rritur përqindjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore.

7. Viza, kontrolli i kufijve, azili dhe migracioni

- Shqipëria duhet të sigurojë në bashkëpunim të ngushtë me PAMECA-n se specifikimet teknike për pasaportat e reja të planifikuara të jenë në përputhje me standartet e BE-së, ve[anërisht lidhur me identifikuesit biometrikë dhe të dhënat të lexueshme nga aparati (makineria).

- Shqipëria duhet të finalizojë dhe të zbatojë planifikimin e saj për Strategjinë e Manaxhimit të Integruar të Kufijve në përputhje me udhëzimet e BE-së sa më shpejt që të jetë e mundur.

- Shqipëria duhet menjëherë të plotësojë me staf Departamentin e refugjatëve në Ministrinë e Brendshme me personel të kualifikuar për të siguruar që aplikimet për azil të ndiqen proceduralisht në përputhje me ligjin.

- Shqipëria duhet të përmirësojë sigurinë dhe manaxhimin e kufirit në aeroportin e Rinasit, duke përfshirë përdorimin në mënyrë efektive pajisjet e reja të instaluar të sigurisë, ve[anërisht lidhur me procesimin e dokumentave të udhëtimit.

- Shqipëria duhet të sigurojë që porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit, Himarës dhe Sarandës të veprojnë në përputhje, sa më shpejt që të jetë e mundur, me Kodin për Marinën Ndërkombëtare dhe Regjimin e Sigurisë në Porte të Organizatës Botërore Detare.

- Shqipëria duhet të forcojë më tej bashkëpunimin operacional ndërmjet shërbimeve doganore dhe policisë kufitare në kufi.

- Shqipëria duhet të sigurojë që Sektori për Migracionin dhe të Huajt në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit të ketë burimet e kërkuara për të për të luajtur rolin e tij në zbatimin e marrëveshjes së ripranimit BE-Shqipëri.

- Shqipëria duhet të sigurojë që Roja Bregdetare shqiptare të veprojë në përputhje me:

a) parimet e komandës civile të pranuar nga Shqipëria në kontekstin e Konferencës Rajonale në Ohër mbi Sigurinë dhe Manaxhimin e Kufirit;

b) Objektivat e partneritetit të NATO-s në fushën e sigurisë në kufi;

c) Udhëzimet për Manaxhimin e Integruar të Kufirit të BE-së për Ballkanin Perëndimor.

- Shqipëria duhet të sigurojë që Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin, mbështetur në mënyrën e duhur nga Departamenti për Refugjatët, të zbatojë në mënyrë efektive procesin e skanimit të kërkesave të azilkërkuësve (pre-screening) dhe emigrantëve në kufi, dhe se burime të mjaftueshme do të alokohen për këtë qëllim në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit firmosur së fundi ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe UNHCR, IOM dhe OSBE-së.

- Shërbimi i Doganave Shqiptare duhet të vërë në zbatim një sistem të vlerësimit efektiv të riskut për të kryer inspektime të përzgjedhura në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe në zonat doganore ku sistemi ASYCUDA tashmë është instaluar.

7. Visa, border control, asylum and migration

- Albania should ensure, in close co-operation with PAMECA, that the technical specifications of the planned new passports comply with EU standards, particularly regarding biometric identifiers and machine-readable data storage.

- Albania should finalise and implement its planned Integrated Border Management Strategy in accordance with EU guidelines as soon as possible.

- Albania should immediately re-staff the Department of Refugees at the Ministry of Interior with qualified personnel to ensure that asylum applications can be processed in accordance with the law.

- Albania should improve security and border management at Rinas airport, including through effective use of newly-supplied security equipment, particularly as regards the processing of travel documents.

- Albania should ensure that Durres, Vlorë, Shëngjin, Himara and Saranda ports comply as soon as possible with the International Ship and Port Facility Security (ISPS) Code of the International Maritime Organisation. In the meantime, Albania should take immediate appropriate measure to upgrade the security arrangements currently in place in these ports.

- Albania should further reinforce operational cooperation between customs services and the border police at the border.

- Albania should ensure that the Sector for Migration and Foreigners in the police Border and Migration Directorate has the resources required to play its part in implementing the EC-Albania Readmission agreement.

- Albania should ensure that the Albanian Coast Guard complies with:

a) the principle of civilian command subscribed to by Albania in the context of the Ohrid Regional Conference on Border Security and Management;

b) NATO partnership goals in the field of border security;

c) the EU Integrated Border Management Guidelines for the Western Balkans.

- Albania should ensure that the Border and Migration Directorate of the ASP, duly supported by the Department for Refugees, effectively implements the pre-screening of asylum seekers and migrants at the border, and that sufficient resources are allocated to that purpose in accordance with the Memorandum of Understanding recently signed between the Ministry of Interior and UNHCR, IOM & OSCE.

- The Albanian Customs Service should put into place an effective risk assessment system for carrying out selective inspections at all border crossing points and customs houses where the ASYCUDA system has already been installed.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN PRILL 2006

I- Projektligje të shqyrtuara në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare.

1. Dekret nr.4806, datë 16.3.2006 "Për kthimin e ligjit nr.9482, datë 16.2.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" (miratuar në seancën plenare të datës 3 prill 2006).

Motivet e kthimit të ligjit nr.9482, datë 16.2.2006 nga Presidenti i Republikës janë:

Së pari, dispozita e nenit 15 të ligjit, pika 2, vjen në kundërshtim me nenet 41 dhe 7 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite dhe dispozitave në vijim të ligjit, territori i zonës, vendbanimit dhe ndërtimit informal rregjistrohet në pronësi të njërive të qeverisjes vendore dhe, më pas, i kalon në pronësi personave që e zotërojnë atë në kundërshtim me ligjin, ndërsa pronarët e ligjshëm kompensohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me metodikën përkatëse. Sipas Presidentit të Republikës, shpronësimi me ligj i pronarëve, në favor të personave që i zotërojnë pronat e tyre në kundërshtim me ligjin, bie ndesh me Kushtetutën e Republikës dhe me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, duke qenë se për një pjesë të pronave e drejta e pronësisë është zgjidhur me vendime gjyqësore, kjo dispozitë zhvlerëson vendimet e gjykatave për të drejtën e pronësisë dhe e ndryshon këtë të drejtë me ligj, duke cënuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Së dyti, autorizimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave të rregjistrimit dhe të kompensimit të pronave të shpronësuara, në paragrafin 3 të nenit 15 të ligjit, nuk jep garanci për mbrojtjen e së drejtës së pronarëve të ligjshëm për sa i përket afatit dhe vlerës së kompensimit.

Së treti, në nenin 42 të projektligjit nuk parashikohet organi administrativ, në të cilin duhet të ankimohen vendimet e njërive të qeverisjes vendore, gjë që e bën këtë nen deklarativ dhe të pazbatueshëm.

Gjatë diskutimit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në seancë plenare, deputetët i vlerësuan të drejta vërejtjet e Presidentit të Republikës dhe i riformuluan dispozitat përkatëse të ligjit. Mendimi i Komisionit ishte që, pasi të jepet leja për legalizimin e parcelës ndërtimore, në favor të subjektit që ka ndërtuar mbi të, të kryhet rregjistrimi i saj në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe, më pas, pronari i ligjshëm të kompensohet, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, mbështetur në metodikën përkatëse.

Problemi që hasi më tepër diskutim kishte të bënte me renditjen në kohë midis legalizimit të parcelës ndërtimore, në favor të subjektit ndërtues dhe kompensimit të ish-pronarëve. Disa deputetë kundërshtuan formulimin e Komisionit përkatës dhe shprehën mendimin që në fillim duhet miratuar vendimi që i jep të drejtën ish-pronarëve për t'u kompensuar në para ose në natyrë, e pas kësaj, duhet kryer rregjistrimi i parcelës ndërtimore në favor të subjektit ndërtues.

Përfaqësuesit e Qeverisë e kundërshtuan këtë mendim, me argumentin që legalizimi është shkaku ligjor për

kryerjen e kompensimit, prandaj pa u kryer akti i legalizimit, nuk mund të kryhet akti i kompensimit.

Në përfundim të diskutimit për këtë dispozitë, Kuvendi vendosi të miratojë propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për këtë çështje. Gjithashtu, Kuvendi miratoi edhe disa ndryshime të tjera në përmbajtjen e ligjit, të propozuara nga përfaqësuesit e Partisë Republikane.

2. P/ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9075, datë 29.5.2003 "Për miratimin e kriterëve dhe termave kryesore të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë" (miratuar në seancë plenare më datë 3 prill 2006).

Projektligji ka për qëllim të bëjë dy ndryshime në ligjin ekzistues:

I- Saktësimin e kriterëve të shlyerjes së borxhit të jashtëm ndaj vendeve joanëtare të Klubit të Parisit, të cilat sipas ligjit nr.9075, datë 29.5.2003, janë:

a) kthimi i borxhit të trashëguar në borxh shtetëror, mbi bazën e marrëveshjeve qeveritare me kushte lehtësuese, ku elementi grant që do të rezultojë nga termat e referencës të mos jetë më i vogël se 35 për qind;

b) eliminimi i interesëvonesave;

c) zbatimi i zgjidhjeve jo më pak favorizuese se zgjidhja e arritur me disa kreditorë të jashtëm para hyrjes në fuqi të këtij ligji;

d) zbatimi i zgjidhjeve jo më pak favorizuese se zgjidhja, kur shlyerja parashikohet të bëhet kundrejt eksportimit të mallrave brenda një periudhe kohore prej jo më pak se 10 vjetësh.

Duke qenë se përdorimi njëkohësisht i të katër kriterëve është i pamundur të arrihet nga Qeveria Shqiptare, gjatë lidhjes së marrëveshjeve qeveritare me vendet që kemi detyrime të pashlyera është marrë në konsideratë kriteri më i favorshëm për vendin tonë ose kombinimi i disa prej tyre.

Për të përputhur përmbajtjen e ligjit ekzistues me praktikën që është ndjekur e do të ndiqet, propozohet që marrëveshjet për shlyerjen e borxhit të jashtëm të trashëguar ndaj kreditorëve që nuk janë anëtarë të Klubit të Parisit të bazohen në një ose në disa nga kriteret që u përmendën më lart.

II- Shtyrjen e afatit të përfundimit të marrëveshjeve bilaterale për zgjidhjen e borxhit të jashtëm nga 31.12.2004, afat i cili ka skaduar, në 31.12.2007.

Duke qenë se ndryshimet e propozuara synojnë saktësimin e kriterëve të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar dhe e bëjnë efektiv ligjin ekzistues gjatë nënshkrimit të marrëveshjeve të ardhshme, deputetët u shprehën dakord me të. Në këtë kuadër, ata kërkuan përshtypjetimin e procedurave nga Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm për rakordimin e shifrave të borxhit dhe për nënshkrimin e marrëveshjeve të riskedulimit të borxhit të trashëguar, pasi shlyerja e tij përbën një detyrim të shtetit shqiptar, në kuadër të marrëveshjes me FMN-në dhe ndikon në marrëdhëniet bilaterale me vendet kreditorë.

(vijon në faqen 12)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN PRILL 2006

(vijon nga faqja 11)

3. P/ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)" dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 "Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995", të ndryshuar.

Emetimi dhe shpërndarja e bonove të privatizimit, në bazë të ligjit nr.7918, datë 13.4.1995, kishte si qëllim shpërndarjen tek shtetasit, mbi bazën e disa raporteve të përcaktuara në ligj, të vlerës së pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore gjatë privatizimit të tyre. Zotëruesit e titujve financiarë të "bonove të privatizimit" kanë të drejtë të përfitojnë si aksionerë, pronarë të pjesshëm ose të plotë të shoqërive tregtare që privatizohen, ose të hyjnë si aksionerë në fondet e investimit të letrave me vlerë.

Në praktikën e deritanishme, tregu i përdorimit të bonove të privatizimit ka qenë mjaft i kufizuar, për shkak se vlera e bonove dhe lekëve të privatizimit të shpërndara në treg nga hyrja në fuqi e ligjit, deri tani, ka qenë disa herë më e madhe se vlera e kapitaleve për t'u privatizuar, kufizimeve ligjore në përdorimin e bonove dhe lekëve të privatizimit në procesin e privatizimit, veçanërisht të objekteve strategjike, si dhe të zvogëlimit të besueshmërisë së zotëruesve të tyre, për shkak të përdorimit të tyre në privatizimin e objekteve me situatë financiare të dobët dhe të krizës së vitit 1997. Për këto arsye, shpërndarja tek shtetasit e bonove të privatizimit është realizuar në masën 68.3 për qind, nga të cilat janë përdorur vetëm 14.6 për qind, si dhe është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme vlera e tyre në treg.

Nëpërmjet këtij projektligji, Këshilli i Ministrave propozon shtyrjen e afatit të përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit nga 31.12.2005, afat i cili ka skaduar, në 31.12.2010.

Gjatë diskutimit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, si dhe në seancë plenare, deputetët u shprehën dakord me propozimin për shtyrjen e afatit të përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit dhe kërkuan që grupi i punës që do të ngrihet nga Këshilli i Ministrave për përgatitjen e kuadrit ligjor, të platformës dhe të programit të përdorimit të bonove të privatizimit, t'i kushtojë rëndësi të veçantë tregut të përdorimit dhe rivlerësimit të këtyre titujve financiarë. Për këtë arsye, nga deputetët u kërkua që, në projektligjet që po përgatiten nga Këshilli i Ministrave për privatizimin e objekteve shtetërore jostrategjike, të trajtohen edhe rregullat për përdorimin e bonove dhe lekëve të privatizimit.

Në përfundim të diskutimit, projektligji u miratua nga Kuvendi me një ndryshim që përputh afatin e hyrjes në fuqi të tij me Kushtetutën.

4. P/ligji "Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorike dhe lundruese të Republikës së Shqipërisë" (miratuar në seancën plenare të datës 3 prill 2006).

Projektligji merr shkas nga rastet e konstatuara të përdorimit të mjeteve private motorike lundruese për kryerjen e trafikëve të jashtëligjshme nëpërmjet detit, siç janë trafikimi i qënieve njerëzore, lëndëve narkotike dhe armëve dhe ka për qëllim pezullimin e lëvizjes së tyre në ujërat territoriale të brendshme, si dhe të transportit të tyre në rrugë tokësore.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, deputetët e mazhorancës shprehën nevojën e miratimit të tij, me argumentin që ai do të ndikojë në kufizimin e hapësirave ligjore për kryerjen e veprimtarive kriminale të trafikut nga brigjet shqiptare, në dhënien e kohës së nevojshme organeve të ruajtjes dhe të kontrollit të kufirit detar për rritjen e kapaciteteve logjistike për parandalimin e trafikëve në hapësirën detare, në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe në rritjen e sigurisë së jetës së qytetarit shqiptar.

Përfaqësuesit e opozitës e kundërshtuan projektligjin, me argumentin që ai kufizon përdorimin e mjeteve motorike, pronë private dhe lëvizjen e lirë të shtetasve, si dhe veprimtarinë e biznesit e të turizmit. Ata ishin të mendimit që shmangja e veprimtarive kriminale dhe e trafikëve duhet të realizohet nëpërmjet rritjes së rolit të policisë kriminale dhe të SHISH-it në luftë kundër tyre, si dhe forcimit të bashkëpunimit midis tyre.

Në përfundim të diskutimit, projektligji u miratua me shumicë votash.

II- Raportime të institucioneve të pavarura

1. Raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (shqyrtuar në seancën plenare të datës 13 prill 2006).

Inspektorja e Përgjithshme e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP), Fatmira Laska, paraqiti para Kuvendit Raportin për veprimtarinë e institucionit që ajo drejton për vitin 2005, e cila është përqendruar në zbatimin me korrektesë të dispozitave të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për

(vijon në faqen 13)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN PRILL 2006

(vijon nga faqja 12)

deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Vëmendja e institucionit është përqendruar në dhënien e ndihmës ndaj institucioneve qëndrore e vendore për të garantuar vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave.

Gjatë diskutimit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe në seancë plenare, deputetët vlerësuan pozitivisht punën profesionale të këtij institucioni në fushën e administrimit dhe të kontrollit të deklarimit të pasurisë, të detyrimeve financiare dhe të parandalimit të konfliktit të interesave për të zgjedhurit, për nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta, përpjekjet për përmirësimin e kuadrit ligjor, për forcimin e strukturave përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit, për rritjen e bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe me ekspertë shqiptarë e të huaj dhe për trajnimin e punonjësve.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi një Rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni gjatë vitit 2005, në të cilën, krahas vlerësimit pozitiv për punën e kryer, kërkohet rritje e mëtejshme e angazhimit për zbatimin me korrektësi të detyrimeve ligjore, përqëndrimi i vëmendjes në luftën kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik, si dhe zgjerimi i veprimtarisë trajnuese ndaj inspektorateve të ulëta.

2. Raporti i Këshillit të Ministrave për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë (shqyrtuar në seancën plenare të datës 20 prill 2006).

Raporti pasqyron veprimtarinë e Qeverisë dhe, veçanërisht, të Departamentit të Administratës Publike, si institucion i specializuar i saj, për menaxhimin e shërbimit civil dhe ristrukturimin organizativo-funksional të institucioneve, me qëllim krijimin e strukturave administrative efektive e të kufizuara në numër. Në Raport theksohet se veprimtaria institucionale për pranimet në shërbimin civil, lëvizjet paralele, ngritjen në detyrë dhe konfirmimin e nëpunësve civilë është kryer në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Raporti gjithashtu pasqyron disa mangësi e shkelje ligjore të konstatuara, si dhe masat disiplinore të propozuara për këto shkelje. Më tej në Raport pasqyrohet puna e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike për trajnimin e nëpunësve civilë, reforma në fushën e pagave dhe objektivat për vitin 2006.

Gjatë diskutimit rreth Raportit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe në seancë plenare, deputetët vlerësuan punën e kryer nga Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e ligjit “Statusi i nëpunësit civil” si dhe atë të Institutit të Trajnimit të Administratës Publike në fushën e trajnimit të nëpunësve civilë.

Deputetët pasqyruan disa mangësi në punën e DAP-it gjatë vitit 2005, siç janë rastet e komprometimit të procedurave të konkurrimit, veçanërisht gjatë fazës së tretë të tij, ku përzgjidhet nga eprori një prej kandidatëve të renditur në tri vendet e para, të shfaqjeve të nepotizmit në administratë, të vlerësimit subjektiv të punës së nëpunësve civilë, të mospërfundimit nga disa institucione të vlerësimit të punës së nëpunësve civilë të tyre etj.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi një Rezolutë për gjendjen në shërbimin civil, në të cilën, krahas vlerësimeve dhe mangësive të konstatuara, pasqyron objektivat për vitin 2006 në fushën e shërbimit civil, siç janë: reformimi i administratës publike dhe rritja e efektivitetit të saj, shkurtimi i strukturave të tepërta e jofunksionale, rishikimi dhe përmirësimi i sistemit të pagave e të shpërblimeve, rritja e objektivitetit në vlerësimin e nëpunësve civilë, shmangja e nepotizmit në administratën publike dhe përmirësimi i procesit të rekrutimit të nëpunësve civilë, mbështetja në përvojat perëndimore, përmirësimi e zgjerimi i teknologjive të informacionit, si dhe përfundimi nga DAP-i i Rregjistrat Qëndror të Personelit.

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN PRILL 2006

Komisioni i Integrimit për muajin prill ka patur aktivitete të ndryshme në lidhje me fushën e kompetencës së tij

Këto veprimtari mund të ndahen në:

Veprimtaria legjislative

Gjatë muajit prill Komisioni i Integrimit ka shqyrtuar disa projektligje. Kryesisht projektligjet konsideronin ratifikimet nga Parlamenti shqiptar i disa marrëveshjeve ndërkombëtare, titujt e të cilëve vijnë më poshtë:

- **Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “Për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar (AGR)**

- **Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa S.P.A., për programin e zhvillimit të sektorit privat, nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sigurimit të asistencës teknike për to”**

- **Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “për punën e ekvipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR)” dhe në protokollin e nënshkrimit e në amendamentin nr. 4 të saj**

- **Për ratifikimin e një ndryshimi në protokollin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë.**

- **Për ratifikimin e marrëveshjes financiare shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondi i Zhvillimit Shqiptar, si agjensi e zbatimit të projektit Kreditaustalt fur wieder-raufbau (KFW) e të marrëveshjes së financimit të projektit (fondi i investimeve sociale-ii)**

- **Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kultures, të arsimit dhe të shkencës.**

- **Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, për realizimin e programit për zhvillimin e sektorit privat, me anën e një kredie ndihmë, për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe sigurimin e asistencës teknike.**

Veprimtaria monitoruese

Në bazë të ligjit 9252 datë 08.07.2004, neni 4 Komisioni i Integrimit ka një rol mbikqyrës mbi Ministrinë e Integrimit. Gjatë kësaj legjislature, takimet me Ministrin për Integrimin Europian kanë qenë jo të shumta, pasi për një periudhë të gjatë kohe, Komisioni për Integrimin Europian ka qënë i boikotuar nga opozita. Për këtë arsye nuk janë zhvilluar mbledhje apo takime të brendshme (nënkuptohen të përjashtuar takimet me delegacionet e huaja që Komisioni ka patur gjatë kësaj periudhe) sepse në rast të kundërt procedurat do të binin në kundërshtim me nenin 34 të rregullores së Kuvendit i cili konsideron të vlefshme mbledhjen vetëm kur mund të plotësohet Kuorum-i. Duke konsideruar që opozita në Parlament përbën mazhorancën në Komision, nuk ishte e mundur të veprimej në bazë të nenit 34 të rregullores. Megjithatë, menjëherë pas zgjidhjes së krizës, dhe kthimit të opozitës në Komision, ky i fundit ka rikonsideruar shkresën që i kishte dërguar Ministrisë së Integrimit kohë më parë për një seancë dëgjimore për ecurinë e negociatave dhe për axhendën e Ministrisë. Takimi u realizua më datë 08.05.2006. Gjatë këtij takimi u diskutua për ecurinë e procesit, për nënshkrimin e marrëveshjes së stabilizim – asociimit, për përgatitjen përballimit të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i MSA dhe për përgatitjen e programit të ardhshëm financiar të BE-së 2007-2013 për Shqipërinë: instrumenti i paraaderimit (IPA).

Ministri i Integrimit raportoi mbi të gjitha pikat e mësipërme dhe hapat e ndërmarrë nga Qeveria aktuale për përmirësimin e gjendjes në Shqipëri. Në shkurt të këtij viti, Shqipëria sigloi marrëveshjen e MSA-së. Po ashtu, pak ditë më parë u siglua marrëveshja e ndërmjetme për lëvizjen e lirë të mallrave.

Me hyrjen në fuqi të MSA-së, Shqipëria do të marrë pjesë në fondet e programeve IPA e cila përfshijnë pesë instrumenta, sikurse janë: asistencë e tranzicionit dhe ngritja e institucioneve, bashkëpunimi ndërkufitar, zhvillimi rajonal, zhvillimi i burimeve njerzore, zhvillimi rural. Shqipëria, si vend kandidat potencial, do të marrë pjesë vetëm në dy zërat e parë të parashikuar nga fondi IPA-së. Përsa sa i përket marrëveshjes së ndërmjetme (ad interim), Ministria e Integrimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë është duke përgatitur materiale informuese mbi përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje, kjo për të përgatitur biznesin shqiptar që të përballojë me efikasitet të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Nga ana Komisionit, pyetjet e anëtarëve ishin nga më të ndryshmet të cilat mund të përmbledhen në çështjet e mëposhtme.

(vijon në faqen 15)

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN PRILL 2006

(vijon nga faqja 14)

- Lobbing-u për firmën dhe ratifikimin e MSA
- Strategjia e Qeverisë për projektet europiane
- Kapacitetet profesionale
- Strategjia e bashkëpunimit rajonal
- Afatet e përafrimit të legjislacionit
- Fondet për përafrimin e legjislacionit dhe përballimit të reformave
- Vlera e shtuar e planit të ri të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*
- Partneriteti evropian dhe koordinimi me planin e ri të përafrimit
- Marrëveshja ad interim
- Masat e Qeverisë për të marrë pjesë në projektet e fondit IPA
- Cili do të jetë funksionimi i zyrave ministrore për integrimin
- Lehtësimi i vizave

- Bashkëpunimi ndërkuftar, modernizimi i kontrollit të kufijve dhe rritja e numrit të pikave të kalimeve kufitare për të evituar bllokimet e herëpërhershme për arsye të fluksit të madh të kalimeve. Ministri i Integrimit e konsideroi të veçantë bashkëpunimin me Parlamentin për çështjet e integrimit të Shqipërisë në BE, dhe për këtë, theksi u vendos në vonesën e madhe për të bërë mbledhje pranë komisionit për shkak të bllokimit institucional të opozitës të pak muajve më parë për çështjen e mocionit kundër kryetarit të Kuvendit. Megjithatë, Ministri theksoi se do të ishte e kënaqur për vazhdimësinë që do ketë puna me këtë institucion.

Më tej, nga ana e Ministrisë u raportua për strukturën ndërministrorë që është ngritur për të përballuar fluksin e madh të punës që vjen nga zbatimimi i MSA-së. Koordinimi i Ministrisë së Integrimit ka bërë që në ministrinë e linjës të ndërtohen zyrat për integrimin evropian.

Deri në këto momente, janë zhvilluar dy raunde negociatash, ku edhe është diskutuar për planin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire*. Plani i mëparshëm kishte shumë mangësi sipas Ministrisë, në të cilin mungonte detajimi i iniciativave ligjore që duhet të ndërmerren si dhe kostot për implementimin. Me ritmin në punë që Ministria ka pasur, 70% e fluksit të punës është përfunduar.

Në planin e përafrimit të legjislacionit është përfshirë edhe dokumenti i partneritetit.

Sikurse u tha edhe më lart, Ministria e Integrimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ekonomisë është duke përgatitur një broshurë informuese për biznesin në lidhje me Marrëveshjen ad interim.

Pikë tjetër e takimit, ishin edhe draft rakomandimet e përbashkëta në takimin e 13-të të grupit të përbashkët konsultativ task forcë BE/Shqipëri.

Rakomandimet ndahen në pikat e mëposhtme:

- Politika antikorrupsion
- Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit
- Policia
- Pastrimi i parave
- Drogat
- Sistemi gjyqësor
- Vizat, kontrolli i kufirit, azili dhe migrimi.

Ministri i Integrimit duke u ndalur në pikat e rekomandive të bëra nga BE, u shpreh se Qeveria ka filluar të ndëmarrë një sërë masash në disa fusha, dhe po vazhdon të ndërhyjë në fushat e tjera të rekomanduara për reformë. Pikat ku dukshëm është ndërhyrë, janë lufta kundër krimit të organizuar dhe lufta ndaj korrupsionit, ndërkohë që po ndërhyhet intensivisht në fushat e tjera për të sjellë në fuqi ligjin e zbatuar dhe për të ndërprerë lidhjet e pushtetit me krimin e organizuar.

Në fund të diskutimeve, Kryetari i Komisionit, u shpreh për vullnetin Komisionit për bashkëpunimin me Ministrinë e Integrimit si dhe, sensibilizimin e Parlamentit për çështjet europiane.

Veprimtari keshilluese në takime dypalëshe.

Komisioni i Integrimit gjatë kësaj legjislature ka pasur takime të ndryshme me delegacione të huaja. Këtu mund të përmenden veçanërisht delegacionet e Komisioneve parlamentare për Çështjet Europiane të Finlandës, të Kroacisë dhe të Republikës Çeke, takimet e të cilave janë fokusuar në shkëmbimin e eksperiencave për procesin e integrimit dhe për mbështetjen që këto vende do t'i japin Shqipërisë në momentin e firmës dhe të ratifikimit të MSA-së.

Një ndër takimet më të rëndësishme ka qenë takimi me reportuesit e Këshillit të Europës (KiE) për të cilin detajet jepen më poshtë.

Vizita e bashkëraportuesve të Komisionit të Monitorimit të Këshillit të Europës (KiE), britanikun David Wilshire, hollandezin Leo Plavoet, dhe punonjësen e sekretariatit, Despina Chatzivasiliou kishte karakter informues në vendin tonë më qëllim përgatitjen e raportit mbi respektimin dhe plotësimin e detyrimeve dhe angazhimeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Shqipërisë në KiE. Gjatë këtij takimi u fol për çështje të ndryshme, siç ishte diskutimi mbi kriteret e Kopenhagenit, të drejtat e njeriut, korrupsioni, puna e Qeverisë së re pas zgjedhjeve, roli i komisionit në procese dhe reforma, sistemi gjyqësor, reforma zgjedhore.

- Kriteret e Kopenhagenit kanë të bëjnë me procesin e integrimit të Shqipërisë në BE, dhe anëtarët e Komisionit u shprehën pozitivisht. Duke marrë par-

(vijon në faqen 16)

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN PRILL 2006

(vijon nga faqja 15)

asysh situatën që ishte Shqipëria në vitet e vendosjes së kriterëve të Kopenhagenit (1993) dhe sot, gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë reforma të vazhdueshme për të arritur standartet europiane. Megjithatë akoma nuk janë arritur nivelet europiane për arsye se Shqipëria është një vend akoma në tranzicion dhe mungon shpeshherë vizioni i demokracisë në vend. Kjo çështje ka lidhje të drejtpërdrejtë me ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Megjithëse Shqipëria ka arritur të vendosë një kuadër të mirë legjislativ, organet qeverisëse nuk arrijnë të venë në zbatim këto norma për arsye të një administrate shpesh të pa përgatitur për të përballuar legjislacionin e ri në fuqi. Kohët e fundit Qeveria e re po merr masa për parandalimin e korrupsionit në të gjitha nivelet administrative, megjithatë ka akoma punë për të bërë sepse mbi këtë çështje duhet të ndërtohet një mentalitet i ri dhe i qartë mbi parimet e demokracisë dhe funksionimit të saj. Po ashtu Qeveria po ndërmerr masa për parandalimin e trafikut ilegal të lëndëve narkotike dhe të qënieve njëzore. Shembull konkret ishte moratorium- i i votuar para pak ditëve në Parlament.

- Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Shqipëria ka ndërtuar një kuadër ligjor të mirë i cili lejon edhe ngritjen e institucioneve të reja për mbrojtjen e tyre në bazë të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Shembull konkret është institucioni i Avokatit të Popullit, institucion ky i cili ka bërë një punë të mirë gjatë veprimtarisë së tij. Por më tepër duhet bërë përsa i përket sensibilizimit të qytetarëve për të drejtat e tyre, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësia e qytetarëve përkundrejt funksionimit të institucioneve të tilla që mbrojnë të drejtat dhe liritë e tyre.

- Qeverisja e mëparshme ishte e stigmatizuar nga të gjitha organizmat ndërkombëtare dhe opinionioni publik vëndas se kishte lidhje të drejtpërdrejta me korrupsionin dhe trafikun ilegal të çdo natyre. Lufta kundër tyre ka qënë e dobët sipas raporteve periodike të Komisionit Europian dhe organizmave të tjera. Për këtë arsye fushata për zgjedhjet e 3 korrikut 2005 nga mazhoranca në fuqi ishte fokusuar në elementet e sipërpërmendur. Qeveria e re ka ndërmarrë iniciativa të ndryshme për të luftuar korrupsionin, krimin e organizuar dhe trafikun ilegal. Disa nga këto iniciativa janë racionale dhe të domosdoshme, disa të tjera kanë qënë të kontestuara nga opozita (moratoriumi). Shqetësime të përgjithshme janë shprehur nga kryetari i komisionit për të mos kthyer luftën kundër korrupsionit në ideologji por ajo duhet të ndërtohet me konsensus të gjërë politik dhe të tregohet dukshëm vullneti politik gjithëpërfshirës. Gjithashtu Qeveria e re duhet të investojë në infrastrukturë dhe të luftojë varfërinë në vend.

- Roli i Komisionit të Integrimit është i një rëndësie të veçantë. Ai po punon për të zbërthyer pikat kryesore që në raportin e fundit të Komisionit Europian janë të shkruara. Përkohësisht, Komisioni ka patur një ndalesë si rrjedhojë e situatës politike të krijuar në Parlament kohët e fundit. Megjithatë ai ka vazhduar takimet e tij konsultative me delegacione të ndryshme. Gjithashtu Komisioni i Integrimit ka kryer rolin e tij monitorues dhe po përgatitet për të shtuar marrëdhëniet me organet qeverisëse. Kryetari i komisionit premtoi që Komisioni do të punojë edhe për përgatitjen e një raporti për ecurinë e vendit që nga raporti i fundit i KiE.

- Sistemi gjyqësor dhe organet ekzekutuese si dhe administrata gjyqësore kanë qënë në qëndër të vëmendjes në raportet e Komisionit Europian për çështjet e korrupsionit dhe shpeshherë janë konstatuar edhe shkelje të të drejtave të njeriut sidomos në kohën e paraburgimit dhe gjatë kryerjes së dënimit. Megjithatë situata në këtë fushë është gjithnjë në përmirësim. Kjo situatë mund të konstatohet edhe në raportet njëpasnjëshme për Shqipërinë. Pavarësisht nga përmirësimet, ka akoma rrugë për të bërë për të garantuar të drejtat e njeriut në të gjitha manifestimet e tij.

- Një rëndësi të veçantë iu dha reformes zgjedhore. Gjatë këtij takimi, raportuesit u sqaruan për sistemin zgjedhor shqiptar dhe në veçanti sistemi artificial i "Dushkut të vogël dhe i Megadushkut" nga ku u pretendua se gjatë zgjedhjeve të 3 korrikut, si nga opozita në figurën e kryetarit, dhe nga mazhoranca u konfirmua që ka pasur mangësi në reformën zgjedhore. Sistemi artificial i filluar në zgjedhjet e 2001 dhe i zmadhuar në zgjedhjet e 3 korrikut 2005, është kritikuar që para zhvillimit të zgjedhjeve duke propozuar modifikime të kodit zgjedhor në Parlamentin e atëhershëm, por këto ndryshime nuk janë marrë parasysh nga ajo mazhorancë. Gjithashtu janë verifikuar edhe rregjistrime jo të sakta të popullsisë si dhe ushtrim presioni nga organet e policisë.

Takimi i Komisionit të Integrimit dhe atij Monitorues, siç u tha edhe më lart, kishte karakter informues për situatën e Shqipërisë dhe progresin e saj gjatë viteve pas raportit të fundit të KiE i 2004.

KALENDAR I

3 Javor (22 maj - 12 qershor 2006) i Punimeve të Kuvendit

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 22.05.2006, ora 18.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60 minuta).
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, të datës 18.05.2006.
3. Miratimi i Programit dhe Kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit.
4. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
5. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës, për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale" dhe të protokollit të saj shtesë".
6. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 9314, datë 11.11.2004 "Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë".
7. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror".
8. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8996, datë 31.1.2003 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (Metrologjinë)".

VEPRIMTARI NË KOMISIONE:

23 Maj – 19 Qershor 2006

1. P/Ligji "Për ratifikimin e disa ndryshimeve në Kushtetutën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë".
-Komisioni i Jashtëm
- Komisioni i Integritimit
- Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
2. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Garancitë Ndërkombëtare në paisjet e lëvizshme dhe në Protokollin e saj".
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
3. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit të Objektivit Strategjik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit".
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm- Komisioni i Integritimit
- Komisioni i Ekonomisë dhe Financës
4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen "Për privilegjet dhe imunitetet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale".
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni i Integritimit
5. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të

dokumentave gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, në fushën civile dhe tregtare".

- **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni i Integritimit
- Komisioni i Sigurisë Kombëtare
6. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës Europiane "Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë".
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni i Integritimit
- Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit
7. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e Programit "Rehabilitimi i Portit të Vlorës".
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit
8. P/Ligji "Për ratifikimin e Amendamentit të Dispozitave, që lidhen me tregtinë, të Traktatit të Kartës së Energjisë".
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Komisioni i Jashtëm
- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
9. P/Ligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira" (grup deputetësh).
-Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
10. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8461, datë 25.02.1999 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
-Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik
11. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", të ndryshuar.
-Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
12. P/Ligji "Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjitik" (grup deputetësh).
-Kom. Përgjegjës: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
- Jep mendim: Komisioni i Ekonomisë dhe Financës
13. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 7941, datë 31.05.1995 "Për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë" (grup deputetësh).
-Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
14. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të ndryshuar.
-Komisioni për Sigurinë Kombëtare
-Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (e ka shqyrtuar)

(vijon në faqen 18)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(vijon nga faqja 17)

15. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore" të ndryshuar (shqyrtimi nen për nen).

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

16. P/Ligji "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar (shqyrtimi nen për nen).

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

17. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit".

-Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

18. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7796, datë 17.02.1994 "Minerar i Shqipërisë", i ndryshuar.

- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

19. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

- Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

- Jep Mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

20. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar (paraqitur nga deputeti N. Lesi).

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

21. P/Ligji "Akti i Lirisë së Shtypit".

- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

22. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope".

- Kom. Përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- Jep Mendim: Komisioni për Sigurinë Kombëtare

23. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

24. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit në njësitë e Qeverisjes Vendore".

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

25. P/vendim "Për ndryshime në Autoritetin Mbikqyrës të Konkurrencës".

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

SEANCË PLENARE

E enjte, datë 25.05.2006, ora 10.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, datë 22.05.2006.
3. Interpelancë me Ministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, kërkuar nga deputeti Flamur Hoxha.

4. Raport i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për veprimtarinë e Bankës për vitin 2005.

5. Miratimi i Projekt Rezolutës për vlerësimin e punës së Bankës së Shqipërisë për vitin 2005.

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 29.05.2006, ora 18.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 25.05.2006.
3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së sigurisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për mbrojtjen e ndërsjelltë të informacionit të klasifikuar".
4. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimat të trafikimit".
5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8461, datë 25.02.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
6. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar (shqyrtimi nen për nen).
7. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar (shqyrtimi nen për nen).
8. P/vendim "Për ndryshime në Autoritetin Mbikqyrës të Konkurrencës".

SEANCË PLENARE

E enjte, datë 1.06.2006, ora 10.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, datë 29.05.2006.
3. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës nr. 168, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia, 1988".
4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për regjistrat e shkarkimit të transferimit të ndotësve".
5. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit të Objektivit Strategjik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit".
6. P/Ligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira" (grup deputetësh).
7. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 8408, datë 25.09.1998 "Për Policinë e Ndërtimit".
8. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", të ndryshuar.

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 5.06.2006, ora 18.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 1.06.2006.

(vijon në faqen 19)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(vijon nga faqja 18)

3. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Garancitë Ndërkombëtare në paisjet e lëvizshme dhe në Protokollin e saj".
4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen "Për privilegjet dhe imunitetet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale".
5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7796, datë 17.02.1994 "Minerar i Shqipërisë", i ndryshuar.
6. P/Ligji "Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjitik" (grup deputetësh).
7. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjërë".

SEANCË PLENARE

E enjte, datë 8.06.2006, ora 10.00

4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për regjistrat e shkarkimit të transferimit të ndotësve".
5. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit të Objektivit Strategjik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit".
6. P/Ligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira" (grup deputetësh).
7. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 8408, datë 25.09.1998 "Për Policinë e Ndërtimit".
8. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", të ndryshuar.

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 5.06.2006, ora 18.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 1.06.2006.
3. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Garancitë Ndërkombëtare në paisjet e lëvizshme dhe në Protokollin e saj".
4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen "Për privilegjet dhe imunitetet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale".
5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7796, datë 17.02.1994 "Minerar i Shqipërisë", i ndryshuar.
6. P/Ligji "Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjitik" (grup deputetësh).

7. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjërë".

SEANCË PLENARE

E enjte, datë 8.06.2006, ora 10.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 5.06.2006.
3. Pyetje dhe interpelanca.
4. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumentave gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, në fushën civile dhe tregtare".
5. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës Europiane "Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë".
6. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e Programit "Rehabilitimi i Portit të Vlorës".
7. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit".
8. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7975, datë 29.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope".

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 12.06.2006, ora 18.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, datë 8.06.2006.
3. Miratimi i Kalendarit 3-javor të Punimeve të Kuvendit për periudhën 12-29 Qershor 2006.
4. P/Ligji "Për ratifikimin e Amendamentit të Dispozitave, që lidhen me tregtinë, të Traktatit të Kartës së Energjisë".
5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar (paraqitur nga deputeti N. Lesi).
6. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit në njësitë e Qeverisjes Vendore".
7. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të ndryshuar.
8. P/Ligji "Akti i Lirisë së Shtypit".

Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit

Alma Kondakçiu
Ditmir Bushati
Denis Gila
Filip Lako

Stafi i Projektit

Sokol Berberi
Denada Breshanaj
Milaim Demnushaj

Qendra e Studimeve Parlamentare
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org

Collaborators for the information on Government and Assembly activities

Alma Kondakçiu
Ditmir Bushati
Denis Gila
Filip Lako

Project Staff

Sokol Berberi
Denada Breshanaj
Milaim Demnushaj

Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org